



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1407/14 prot.

Tiranë më 19.08.2024

URDHËR

Nr. 133, datë 19.08.2024

PËR KONTROLLUESIN SHKOLLA E MESME ARTISTIKE “ONUFRI”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Shkolla e Mesme Artistike “Onufri”, Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Elbasan (në vijim “ZVAP Elbasan”), Zyrës së Gjendjes Civile Elbasan, si dhe Arkivit pranë Prefekturës Elbasan.

KONSTATOVA SE:

1. Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”), ka administruar ankesën e znj. ... (...) **nr. 1407 prot., datë 30.05.2024**, nëpërmjet të cilës ankuesja pretendon se ka paraqitur kërkesë pranë Shkollës së Mesme Artistike Onufri dhe ZVAP Elbasan, për korrigjim të të dhënave në dokumentin shkollor “Vërtetim note” në rubrikën “emër” nga “... ” në “... ”, dhe në rubrikën “mbiemër” nga “... ” në “... ”, por nuk ka marrë zgjidhje lidhur me këtë pretendim.
2. Bazuar në germën “ë” pika 1, e nenit 31 të Ligjit, në kompetencat e Zyrës së Komisionerit, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, është edhe zgjidhja e ankesave të subjektit të të dhënave për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tij, për përpunimet e të dhënave personale dhe vënien e tij në dijeni për zgjidhjen e ankesës së paraqitur.
3. Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit, nëpërmjet **shkresës nr. 1407/1 prot., datë 10.06.2024**, i është drejtuar ZVAP Elbasan, me kërkesë për informacion, duke i bërë me dije se, bazuar në nenin 13 të Ligjit, parashikohet e drejta për të kërkuar bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, si një e drejtë e rëndësishme e subjektit të të

dhënave, që lejon këtë të fundit, për të kërkuar nga Kontrolluesi bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij/saj nuk janë të rregullta, të vërteta ose të plota.

4. Në vijim ZVAP Elbasan, ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 600 prot., datë 24.06.2024, administruar në Zyrën e Komisionerit **nr. 1407/2 prot, datë 26.06.2024**, ku ndër të tjera, bën me dije se Gjumnazi Artistik “Onufri” dhe ZVAP Elbasan nuk mund të kryejnë asnjë ndërhyrje apo korrigjim në Amëz pasi konsiderohet si vepër e kundraligjshme duke u bazuar në nenin 109 të urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 “*Për miratimin e Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore*”. Amza plotësohet dhe përdoret sipas udhëzimeve në faqen e saj të parë. Shkolla e mesme artistike “Onufri” dhe ZVAP Elbasan nuk disponon asnjë lloj dokumenti ku të verifikohet dhe provohet se me çfarë dokumenti është regjistruar paditësja për të ndjekur shkollën në Shkollën e Mesme Artistike “Onufri”. Për sa më sipër, ZVAP Elbasan e ka orientuar të interesuarin për zgjidhjen e kësaj çështjeje nëpërmjet procesit gjyqësor sipas ligjit në fuqi.
5. Zyra e Komisionerit, nëpërmjet **shkresës nr.1407/4 prot, datë 02.07.2024** mbi njoftimin e ushtrimit të hetimit administrativ ka dërguar Urdhrin nr. 109, datë 02.07.2024 dhe **shkresës nr.1407/7 prot, datë 04.07.2024** dhe Urdhrin nr.120, datë 04.07.2024, mbi zhvillimin e hetimeve administrative, pranë ZVAP Elbasan dhe Shkollës së Mesme Artistike “Onufri” me objekt:
 - Verifikimi ankesës të paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar.
6. Zyra e Komisionerit, nëpërmjet shkresës **nr. 1407/8 prot., datë 12.07.2024**, i është drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile Elbasan si dhe Arkivit Pranë Prefekturës Elbasan, duke kërkuar informacion nëse në regjistrat tuaj rezulton person me gjeneralitet si vijon:
 - ... , e bija e ... dhe e ... , e datëlindjes ... , vendlindja “... ”.
 - ... , e bija e ... dhe e ... , e datëlindjes ... , vendlindja “... ”.Si dhe nëse figuron tjetër person në regjistrat tuaj me gjeneralitetet si vijon:
 - ... , e bija e ... dhe e ... , e datëlindjes ... , vendlindja “... ”.
7. Në përgjigje për sa më sipër, Prefekti i Qarkut Elbasan, me shkresën nr. 791/1 prot., datë 17.07.2024, administruar në Zyrën e Komisionerit **nr.1407/9 prot, datë 19.07.2024**, ndër të tjera bën me dije se nga verifikimet e kryera në regjistrat që disponon arkiva e Gjendjes Civile Elbasan, konkretisht akti i lindjes Nr. ... datë ... që i përket shtetases në fjalë të dhënat e saj janë:
 - ... , atësia ... dhe amësia ... e lindur në ... datë Kjo shtetase është regjistruar në fletën e familjes me referencë “... ” me këto të dhëna ...”.Bashkëlidhur shkresës është vënë në dispozicion certifikatë nga akti i lindjes me nënshkrim elektronik për të cilën arkiva ka akses.

8. Ndërsa, Gjendja Civile Bashkia Elbasan, kthen përgjigje me shkresën nr. 45 prot., datë 22.07.2024, administruar në Zyrën e Komisionerit **nr.1407/10 prot, datë 24.07.2024**, ku ndër të tjera bën me dije se, “...duke filluar nga data 01.07.2024, Regjistrat Themeltar të shtetasve dhe dokumentet e tjera arkivore janë transferuar pranë Zyrës së Arkivit të Gjendjes Civile pranë Prefekturës Elbasan. Nisur nga sa më sipër, përgjigjen për rastin do ta merrni pranë kësaj zyre.
9. Në përfundim të hetimit administrativ pranë Kontrolluesit Shkolla e Mesme Artistike “Onufri” dhe në zbatim të kërkesave të urdhrave të sipërcituar dhe korrespondencave përkatëse nga ana e grupit të inspektimit të Zyrës së Komisionerit me shkresën **nr.1407/11 prot, datë 26.07.2024** është mbajtur “**Procesverbali i Hetimit Administrativ**”. Në bazë të konstatimeve të grupit të inspektimit dhe referuar dokumenteve bazë të gjendjes civile të administruara gjatë hetimit administrativ, vërtetohet se ankuesja ... , është e bija e “... ” dhe e “... ”, e datëlindjes ... , lindur në ... , me aktin e lindjes nr. ... , datë Në këto kushte, Kontrolluesi duhet të plotësonte dokumentacionin shkollor përkatës konform kompetencave ligjore, duke pasqyruar të dhënat e ankueses në mënyrë tërësisht identike, sikurse rezultojnë në aktet e gjendjes civile dhe jo të pasqyrojnë të dhëna të ndryshme dhe të pasakta sikurse ka ndodhur në rastin konkret, lidhur me emrin dhe mbiemrin e ankueses. Nga ana e Zyrës së Komisionerit, vlerësohet se të dhënat e pasqyruara në dokumentin shkollor “Vërtetim note”, të lëshuar nga Kontrolluesi me nr. 45 prot., datë 22.07.2024, sa i përket emrit dhe mbiemrit të ankueses, ata janë pasqyruar në mënyrë të pasaktë.
10. Gjithashtu, pas verifikimit të faqes së parë të amzës, rezulton se: “1-Regjistri i amzës është dokumenti më i rëndësishëm i çdo shkollë; 2- Çdo shkollë ka regjistrin e saj të amzës; 3- Regjistrat e amzës ruhen përgjithmonë në drejtorinë e shkollës. Kur me vendim të organeve përkatëse shkolla mbyllet, regjistri i amzës dorëzohet me procesverbal në Arshivën e Shtetit (ose arshivën rajonale); 4- Drejtori i Shkollës është i detyruar të marrë gjithë masat për plotësimin e amzës në kohë dhe sipas rregullave; 5- Në fund të çdo viti shkollor, për secilin nxënës, plotësohen të gjitha kërkesat e amzës; 6- **Kur nga pakujdesia bëhet ndonjë gabim, ai korrigjohet nga sekretaria e shkollës në prezencën e drejtorit të shkollës, duke bërë shënimet mbi natyrën e korrigjimit dhe nënshkruhet nga të dy;** 7- Çdo nxënës i shkollës ka vetëm një numër amze...”
11. Sa më sipër, me qëllim zgjidhjen sa më të drejtë të çështjes, Zyra e Komisionerit ka thirrur në një seancë dëgjimore përfaqësues të Shkollës së Mesme Artistike “Onufri”. Në seancën e zhvilluar në datë 01.08.2024, ora 11:00, me përfaqësuesin e Shkollës së Mesme Artistike “Onufri”, ky i fundit, mbajti të njëjtin qëndrim si në shkresën kthim përgjigje dërguar Zyrës së Komisionerit.

Nga sa rezultoi nga seanca dëgjimore e zhvilluar me përfaqësuesin e Shkollës së Mesme Artistike “Onufri”, dokumentacionin bashkëlidhur ankesës dhe provave të administruara gjatë procedurës administrative, kemi të bëjmë me një gabim “material”, bazuar në nenin 112 të ligjit nr. 144/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se : “*Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë,*

mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ”.

Në këtë rast, Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi ka detyrimin që të përpunojë/publikojë të dhëna personale të subjekteve të të dhënave duke respektuar parimin e ligjshmërisë së përpunimit dhe në përputhje me kriteret ligjore të përpunimit parashikuar në nenet 5 dhe 6 të Ligjit, ku konkretisht në nenin 5, pika 1, germa “ç”, parashikohet se: *“Mbrotjtja/përpunimi i të dhënave personale bazohet ndër të tjera, në saktësinë që të dhënat duhet të kenë, dhe kur është e nevojshme, duhet të përditësohen; duhet ndër marrë çdo hap i arsyeshëm për të fshirë apo korrigjuar të dhëna të pasakta apo të paplota, në lidhje me qëllimin për të cilin janë mbledhur apo për të cilin përpunohen më tej.”.*

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të kërkojë bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat e ligjit të sipër cituar (*Pika 1, e nenit 13, të Ligjit*).

Në këtë kuadër, është detyrim i Kontrolluesit të kryej vetë ose me kërkesë të subjektit të të dhënave bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale, kur vëren se të dhënat janë të parregullta, të pavërteta, të paplota ose janë përpunuar në kundërshtim me dispozitat e nenit 19, të Ligjit si dhe të informojë marrësin e të dhënave personale për korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale, të transmetuara para korrigjimit apo fshirjes. Ndërkohë, germa “b” e pikës 1, të nenit 30, të Ligjit përcakton se: *“Komisioneri ka këto të drejta: b) urdhëron bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullon përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale”.*

Sa më sipër, në zbatim të nenit 5 pika 1, germa “ç”, neneve 6, 13, 19, 29, 30 pika 1, germa “b” dhe 32 të Ligjit,

URDHËROJ:

1. Kontrolluesi Shkolla e Mesme Artistike “Onufri”, të realizojë në mënyrë të menjëhershme, korrigjimin e të dhënave në dokumentin shkollor “Vërtetim note” në Rubrikën “emër mbiemër” në “... ”.
2. Kontrolluesi Shkolla e Mesme Artistike “Onufri”, të informojë subjektin e të dhënave personale znj. ... , për korrigjimin e të dhënave personale.
3. Kontrolluesi Shkolla e Mesme Artistike “Onufri”, mbart detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit, lidhur me zbatimin e detyrave të lëna në këtë urdhër, brenda 30 ditëve.
Afati i sipërpërmendur, fillon nga data e marrjes në dijeni të këtij akti.
4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas pikës 2, të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e

përsëritura të moszbatimit të Urdhrave të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative.

Ky Urdhër u shpall sot më datë 19.08.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi